



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3274 Prot.

Roskovec, më 30.04 2021

VENDIM

NR 24 .DATË 29.04 .2021

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN MARS DHE PRILL 2021”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 31.03.2021, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2021.
- 2- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 08.04.2021, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Prill 2021.
- 3- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 25461 Prot.

Roskovec, më 01.04.2021

Procesverbal Nr.3

-I mbajtur sot, date 31.03.2021, ora 12, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite si me poshte :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt 2021.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Informacion mbi pyetësoin për transparencën e Këshillit Bashkiak gjatë vitit 2020.
5. Për miratimin e raportit të punës së Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
6. Për miratimin e raportit të transparencës për vendimmarrje i Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
7. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 Shkurt 2021.
8. Për miratimin e rregullores “Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e Strukturave Komunitare në Bashkinë Roskovec”.
9. Për disa shtesa në Vendimin Nr.88 datë 22.11.2020 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2021”.
10. Për një ndryshim në shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit”.
11. Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2022-2024.
12. Për një ndryshim në listën përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në territorin e Bashkisë Roskovec, të miratuar me VKM Nr.770 datë 24.09.2010.
13. Për ndërtimin e rrugës lidhëse ndërmjet rrugës së liqenit dhe rrugës Qemal Jano, Roskovec.
14. Informacion mbi raportin e monitorimit të 4-mujorit të III viti 2020.
15. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 12⁰⁵

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, L.Goga, B.Çobo, B.Kuka, T.Kuka, D.Hoxha, K.Hyska, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : K.Kuka, E.Cepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, G.Hoxha, A.Sheme, V.Stani.

Prezent nga bashkia: Kryetarja e bashkise, Dr. Juridike, P/Dr. Ekonomike, juristja e urbanistikes, P/Z/Ndihmes Ekonomike, P/Z/tatim-taksave. Prezent edhe disa qytetar nga Mbersi. Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 14 keshilltare. Para se te filloje mbledhjen, kryetari ben me dije se ne piken nr.13 te rendit te dites, kemi nje pike shtese "Zgjerimi i rruges Jashar Menga, fshati Luar". Pra pervec "ndertimit te rruges lidhese ndermjet rruges se liqenit dhe rruges Qenan Jaho, Roskovec", do te shtojme ne kete projekt-vendim edhe "zgjerimi i rruges Jashar Menga, fshati Luar", te cilat do te kalojne per miratim sipas rendit te dites. E hedh ne votim per ta shtuar si pike ne rendin e dites dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro. Kryetari fillon me pikat e rendit te sotem.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesen e bere si me siper dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Shkurt 2021.

Sekretarja e keshillit sqaron informacionin. Sqaron ne lidhje me vendimet e miratuara dhe te zbardhura. Nje vendim ishte akt normativ, i cili eshte miratuar nga Prefektura Fier.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se Shkurtit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

4. Informacion mbi pyetesorin per transparencen e Keshillit Bashkiak gjate vitit 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron ne lidhje me anketimin per transparencen e keshillit per vitin 2020, i cili u publikua ne web dhe rrjetet sociale te bashkise dhe keshillit. Sqaron se rezultatet e pyetesorit kane qene pozitive, por gjithmone ka vend per permiresime te metejshme.

5. Per miratimin e raportit te punes se Keshillit te Bashkise Roskovec per vitin 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron raportin e punes 2020. Jane miratuar 101 vendime, vetem 2 prej tyre nuk jane konfirmuar nga Prefektura Fier dhe jane anuluar po me vendim keshilli. Pjesen me te madhe e zene vendimet per problemet sociale dhe per familjet ne nevojte. Hidhet ne votim raporti i punes se keshillit per vitin 2020 dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

6. Per miratimin e raportit te transparences per vendimmarrje i Keshillit te Bashkise Roskovec per vitin 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron raportin e transparences se keshillit per vitin 2020. Sqaron se keshilli ka zhvilluar 16 degjesa publike, 2 prej tyre online. 25 vendime jane kaluar sipas procedures se konsultimit publik. Hidhet ne votim raporti i transparences ne vendimmarrje per vitin 2020 i keshillit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

7. Per dhenien e Ndihmes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-28 Shkurt 2021.

Elis Apostoli sqaron materjalin. Kadriu-ne cilen date e marrin qytetaret pagesen e ndihmes ekonomike dhe te 6%? Ka nje date fikse per kete? Elisi sqaron se ne i cojme listat kur na vjen vendimi nga drejtoria, por ne fshatra vonesa e tyre varet nga posta jo nga ne. Edhe kryetarja sqaron se edhe une kam shume raste qe njerzit ankohen per vonesa ne pagesa, kam biseduar edhe me posten dhe postieret per kete problem, une kam kerkuar qe qytetaret ta marrin pagesen ne banke, por banka raifeisen nuk ka pranuar ta marri si sherbim. Eshte problem me posten shqiptare per vonesat e pagave te qytetareve. Vjollca-sigurimet shoqerore per kujdestaret Janar-Shkurt-Mars 2020 nuk jane hedhur. Elisi sqaron se ne ua kemi derguar qe atehere dhe ua kemi riderguar perseri, sepse keto mund te jene ngaterruar gabimisht ne protokoll. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

8.Per miratimin e Rregullores “Per ngritjen,funksionimin dhe nderveprimin e Strukturave Komunitare ne Bashkine Roskovec”.

Dr.Juridike sqaron rregulloren per ngritjen,funksionimin dhe nderveprimin e strukturave komunitare.Ne rregullore jane percaktuar te gjitha procedurat qe do te ndiqen ne zgjedhjen e strukturave komunitare.Leksi-kush do e ndjeki zbatimin e kesaj rregulloreje dhe a ka penalitete nese nuk zbatohet?Dr.Juridike sqaron sipas ligjit.Hidhet ne votim rregullorja per ngritjen,funksionimin dhe nderveprimin e Strukturave Komunitare dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

9.Per disa shtesa ne Vendimin Nr.88 date 22.11.2020 “Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2021”.

P/tatim-taksave D.Goga sqaron projektin dhe shtesat e bera sipas VKM-se qe qeveria ka marr.Dhe pika e 2 e cila eshte nje tarife e perkohshme per rehabilitimin e kanaleve kulluese ne fshatin Marinez-per kompanine Albpetrol sh.a.Kryetarja sqaron ne lidhje me tarifen e perkoheshme,sapo te merren leket nga Albpetroli do te kete nje projekt vetem per Marinzen.Hidhet ne votim projekti i disa shtesave ne Paketën Fiskale 2021 sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

10.Per nje ndryshim ne shpronesimin,per interes pubik,te pasurive te paluajtshme prone private,qe preken nga projekti “Permiresimi i furnizimit me uje te pijshem per qytetin e Roskovecit”.

Dr.Juridike sqaron projektin.Jane rivleresuar edhe njehere kulturat bujqesore nga AREB Lushnje,dhe nga rivleresimi i tyre,kemi nje ndryshim te vleres se shpronesimit sipas shkreses se AREB Lushnje.Kjo ka ardhur si rezultat i procedures ligjore.Pas miratimit te ketij projekti do te vijojme perseri me procedurat ligjore.Kryetarja sqaron ne lidhje me projektin,vendimet qe marrim ne kontrollohen nga ministria perkatese,sepse kjo eshte procedura ligjore.Bujari-pse kaq procedura te gjata,sepse kjo ka kaluar njehere ne keshill?Kryetarja sqaron se keshtu e percakton ligji,nuk veprojmë dot ndryshe.Delina-rivleresimi eshte bere vetem per kulturat bujqesore.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro (3/5+1) vota pro.

11.Per miratimin e tavaneve pergatitore te shpenzimeve per programin buxhetor afatmesem 2022-2024.

P/Dr.Ekonomike sqaron projektin,kemi bere pergatitjen e tavaneve te shpenzimeve buxhetore 2022-2024.Eshte nje detyrim ligjor.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti i tavaneve te shpenzimeve per programin buxhetor 2022-2024 dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

12.Per nje ndryshim dhe shtese ne listen e inventarit,miratuar me VKM Nr.770 date 24.09.2010 “Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike,shteterore,qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Roskovec” dhe VKB Nr.48 date 29.06.2020 “Per perditesimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore qe ndodhen ne territorin e Bashkise Roskovec”.

Kryetari pyet nese ka diskutime?Nuk ka.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro sipas materjalit.

13.Per miratimin e projektit me objekt “Ndertimi i rruges lidhese ndermjet rruges se liqenit dhe rruges Qenan Jaho”,dhe projektit me objekt “Zgjerimi i rruges Jashar Menga,fshati Luar”.

Leksi-kerkon sqarim per rrugen lidhese ndermjet rruges se liqenit dhe rruges Qenan Jaho.Juristja e urbanistikes sqaron ne lidhje me pyetjen.Kryetarja-sqaron se tek rruga e liqenit,mbrapa radhes se pare te shtepive,nje kanal qe ka qene ekzistent sot ka dal jashte funksionit.Duke qene se kjo pjese e kanalit eshte mbushur se jane bere ndertime,ne mendojme qe pjese e kanalit te kthehet ne rruge

lagje,e cila u sherben atyre banoreve atje.Per kete arsye miratuat edhe ndryshimin e inventarit nga kanal ne rruge.Rruga e dyte eshte ne Luar,nga ankesat e banoreve per te dale ne rrugen kryesore,asnje nga fermeret nuk e ka ate ne pronesi,por e kane zaptuar.Kur aty ka nje ankese nga banoret,ne futemi bejme verifikime dhe nderhyjme me vendime per ti dhene zgjidhje problemit.Kryetarja sqaron se projekti do te saktosohet me gjith elementet e duhur,edhe me vleren financiare perkatese.Pas zbardhjes se vendimit,une do nxjerr urdher per hapjen e rruges sipas hapave ligjor.Duhet ti japim te drejten cdo banori.Vjollca-ne kemi marr vendime per rruge,ura por a do cohen deri ne fund?Hidhet ne votim projekti me shtesat e bera si me siper per te dyja rruget,asaj lidhese ndermjet rruges se liqenit dhe rruges Qenan Jaho Roskovec,dhe zgjerimi i rruges Jashar Menga,fshati Luar,dhe miratohen unanimitisht me 14 vota pro.

14.Informacion mbi raportin e monitorimit te 4-mujorit te III viti 2020.

P/Dr.Ekonomike sqaron se eshte detyrim ligjor per njohje nga keshilli i raportit te monitorimit per 4-mujorin e III te vitit 2020.Nuk ka diskutime.

15.Diskusione dhe komente te qytetareve.

Kryetari-kerkon sqarim ne lidhje me rregulloren per vendosjen e tendave,eshte percaktuar ngjyra dhe modeli i tyre?se mund te kete kerkesa nga qytetaret?Vjollca-kam bere nje ankese per qytetarin Viktor Dosti ne lidhje me problemin qe ka me kempin,i cili pretendon se e ka fituar kempin.Punonjesi i ndihmes sociale sqaron se dosja nga ne eshte nisur ne 6.10.2020 dhe ne nuk na ka ardhur akoma vendimi perfundimtar nga kempin epror.Qytetari dhe gruaja e tij jane prezent.Gruaja sqaron se ne 2012 ne na eshte nderprere kempin,ne 2019 burri u semur prape,i morem letrat nga Tirana,i dorezuam tek Adisa ne Fier.Punonjesit e ndihmes ekonomike sqarojne problemin ne baze te dokumentave qe disponojne ne dosje,ne korrik 2020 ti ke sjelle fleten e drejtimin per kempin,po nuk ishte diagnoza e mjekut ne nuk percjellim dot dokumenta.Ne si bashki i kemi cuar ne tetor 2020 dhe akoma nuk na ka ardhur vendimi i komisionit.Alketi-te nje parcele gjate pastrimit te ujerave te zeza eshte demtuar nje ure,banoret kane kerkesa per tu bere prape kjo ure.Te shtepia e Trifon Goges eshte nje kabine e cila eshte e parrethuar dhe ven femijet.Kryetarja jep lajmin e ndertimit te cerdhes e cila do ju vij mbledhjen tjeter,presim nje pjese te financimit nga banka Raifeisen,pjesa tjeter do jete rialokim fondesh.Lajmi i dyte eshte per unazen perendimore te Roskovecit,FZHR sapo e ka miratuat projektin,ajo eshte nje rruge qe fillon nga baxhua dhe eshte e domosdoshme.Leksi-problemi i pikes se skrepit ne bllokun Nr.2.Leksi pyet edhe per premtimet qe na dha drejtori i OSHE-se,cfare po behet do marrin zgjidhje?Kryetarja sqaron ne lidhje me problemet e OSHE.Nuk ka me pyetje.Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al
Nr. 276/11 Prot.

Roskovec, më 28.04.2021

Procesverbal Nr.4

-I mbajtur sot, date 08.04.2021, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje jashte radhe me kerkese te Kryetares se Bashkise, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e përdorimit të fondit për mbrojtjen civile për ndërtimin emergjent të objektit : “Përforcim i Urës Auto mbi kolektor, fshati Suk 2”.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11¹⁰

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, L.Goga, B.Çobo, B.Kuka, D.Hoxha, K.Hyska, G.Hoxha, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, V.Stani, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : E.Cepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, T.Kuka, A.Hazizi, K.Kuka.

Prezent nga bashkia: Nenkryetari i Bashkise Maksim Goga, Dr.Ekonomise Selman Cepele.

Me plotesimin e kuorumit , kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes 15 keshilltare. Kryetari i falenderon per gadishmerine e treguar ne mbledhjen e sotme. Kryetari fillon mbledhjen.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i mledhjes dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro.

2. Per miratimin e perdorimit te fondit per mbrojtjen civile per ndertimin emergjent te objektit : “Perforcim i Ures Auto mbi kolektor, fshati Suk 2”.

Nenkryetari M.Goga falenderon per pjesmarrjen. Sqaron problemin e ures ne fshatin Suk 2, e cila ka dite qe ka shkare nga shirat, dhe eshte bere e pakalueshme nga njera ane. Nga fondi specific i emergjencave propozojme ndertimin emergjent te kesaj ure, eshte problem emergjent se rrezikohen banoret e zones. Genci-ku ndodhet kjo ure? Nenkryetari sqaron se ndodhet ne fshatin Suk 2 te rukanjaret. Bujari-kjo ure lidh dy lagje apo eshte ne rruge kryesore? Nenkryetari-lidh dy lagje. Vjollca-jam dakort te rindertohen te gjitha urat. Leksi-sa kohe ka kjo ure, dhe pse nuk e sollet ne mbledhjen e pare? Nenkryetari sqaron se i bem nje rimbushje por nuk mbajti. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro sipas materjalit te paraqitur. Vjollca-pyet per uren e Mbersit? Nenkryetari-eshte planifikuar dhe do behet. Leksi-qytetaret me kane ngritur problemin per qent endacak dhe rrugecer. Nuk ka me pyetje. Mbyllet mbledhja.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska